



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, **Zizë Bujupaj**, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë; dhe

"AAG PROJEKT" nga Prishtina, Komuna Prishtinës, të cilën e përfaqëson, z. **Bajram Beqiraj**, me Nr. Rexh. Biznesi, 71363635 (në vazhdim "Kontraktuesit"), në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

NDËRTIMI I DEPOSË PËR DRU NË SHTËPINË E KOMUNITETEVE NË GURRAKOC-Lot 3

Nr. Irokurimit	633-19/1970 / 521/ C214 – lot 3
Nr. I brendshëm	633 / 019 / 022 / 521

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

NDËRTIMI I DEPOSE PER DRU NË SHTËPINE E KOMUNITETEVE NË GURRAKOC

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi i punëve për punimet **NDËRTIMI I DEPOSE PËR DRU NË SHTËPINE E KOMUNITETEVE NË GURRAKOC** është: 4.271,00 € dhe me fjalë:
/Katërmijëedycindeshtatëdhjetënjë/zeuro-zero/

2.3. *Oferta financiare e kontraktorit e datës: 03.05.2019 është pjesë integrale e kontratës dhe bazë për pagesën e kontratës.*

2.4. *Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.*

2.5. *Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.*

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 *Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:*

*Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës*

3.2 *Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.*

Neni 4 Komunikimet

4.1 *Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.*

4.2 *Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.*

4.3 *Kudo në kontratë parashikohet për dhëniën e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.*




4.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:

Komuna e Istogut

Per kontraktorin:

“AAG PROJEKT” shpk

Emri:	Zize Bujupaj	Emri:	Bajram Beqiraj
Pozita:	Zyrtar Pergjegjes i Prokurimit	Pozita:	Me n a x h e r,
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data	19. 6. 2019	Data	19.06.2019
V u l a:		V u l a	

Numri i Prokurimit: 633-19-1970-5-2-1-----633/19/022/521- Titulli : LOTO 1-NDERTIMI I DEPOS NE SHKOLLEN FILLORE TREPÇA-BANJE, LOTO 2-NDERTIMI I DEPOS NE KOPSHTIN E FEMIJEVE LULETB E JETES-VRELLE,dhe LOTO 3-NDETIMI I DEPOS NE SHTEPINE E KOMUNITETIT NE GURRAKOC

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

~~19 dhe zimet për plotësimin e KVK janë dhënë sipas nevojës në shënimet kursive të përmenduar për nenet përkatëse të KPK. Shumato të relevante~~

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK	
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.		
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.	
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë: GJUHA SHQIPE.	
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është: 10% E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 90 DITE.	
Përgjegjësia Sigurimi Kontraktuesit	Shuma minimale dhe i	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: (a) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim lidhur me punët, ndonjë pjesë të tyre, materialet apo impiantin gjatë periudhës mbi të cilën kontraktuesi është përgjegjës për përkujdesjen e tyre, për çfarëdo arsye, përpos rreziqeve të definuara sipas nenit 38 të KPK, kontraktuesi korrigjon humbjen apo dëmtimin e tillë nën shpenzimet e veta, në mënyrë që punët e përhershme në çdo aspekt të jenë në përputhje me dispozitat e kontratës sipas kërkesave të menaxherit të kontratës. Kontraktuesi siguron punët, së bashku me materialin dhe impiantin gjer në koston e zëvendësimit të plotë; (b) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim Pajisjeve në shumë e cila është e mjaftueshme për zëvendësimin e tyre; (c) Nëse ndodh ndonjë humbje apo dëmtim pronës (përveç Punëve, Impianteve, Materialeve dhe Pajisjeve) në lidhje me Kontratën shuma minimale është 15.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar. (d) Nëse ndodh ndonjë dëmtim personal ose vdekje: (i) e punëtorëve të Kontraktuesit: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar e personave të tjerë: 50.000 euro për çdo ndodhi, kurse numri i ndodhve është i pakufizuar	
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë ;max 5 dite nga nënshkrimi i kontrates	
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 60 DITË.	
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 125% e Çmimit përfundimtar të Kontratës për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.për ditë.	

Numri i Prokurimit: 633-19-1970-5-2-1-----633/19/022/521- Titulli : **LLOTO 1-NDERTIMI I DEPOS NE SHKOLLEN FILLORE TREPÇA-BANJE, LLOTO 2-NDERTIMI I DEPOS NE KOPSHTIN E FEMIJEVE LULETB E JETES-VRELLE,dhe LLOTO 3-NDETIMI I DEPOS NE SHTEPINE E KOMUNITETIT NE GURRAKOC**

		Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10% e Çmimit final të Kontratës.
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është:DREJTORATI I ARSIMIT (per loto 1 dhe 2,kurse per Loto 3-Drejtorati i Shendetesise,gjegjesisht personat e caktuar me vendim nga ZKA-ja.
Parapagimi	26.1	Shu lloto)ma e Parapagimit është:NUK KA
Mbajtja e Parasë	27.1	Shuma e parave të mbajtura është:Sigurimi i cilesise se punimeve me vlefshmeri 12 muaj.
Shkaqet për kompensim	30.1	Data e posedimit të vend punimit do të jetë:5 ditë pas nënshkrimit të kontratës.
Përgjegjësia rmbi Defektet	34.5	Periodha garantuese e defekteve është 30 ditë
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	39.1	Përqindja që do të zbatohet përvlerën e punëve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Punëve, është përqindja e vlerësuar të punëve të pakryera minus shuma e dëmeve te likuiduara.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik - Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykatën Themelore-Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë.